



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“FERMA BUJQËSORE DHE BLEGTORALE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelist III të KEK²

K-H2-III-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përbatja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi	4
Kohëzgjatja.....	4
Niveli	4
Qëllimi:.....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:.....	4
Mundësitet e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Datae validimit	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
Kompetenca të përgjithshme	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
H2-08-III-0159-24 Planifikimi dhe organizimi punës në fermat bujqësore dhe blegtoriale	5
Rezultatet e të nxënët në njohuri	5
Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale	6
Kritere vlerësimi.....	6
H2-08-III-0160-24 Teknologjite e prodhimit bimor	6
Rezultatet e të nxënët në njohuri	6
Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale	7
Kritere vlerësimi.....	8
H2-08-III-0161-24 Teknologjite e prodhimit blegtoral	8
Rezultatet e të nxënët në njohuri	8
Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale	9
Kritere vlerësimi.....	10
H2-08-III-0162-24 Teknologjite e prodhimit biologjik	10
Rezultatet e të nxënët në njohuri	10
Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale	11
Kritere vlerësimi.....	11
H2-08-III-0163-24 Përpunime të thjeshta të prodhimit në fermat bujqësore dhe blegtoriale	12

Rezultatet e të nxënësit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënësit në shprehi profesionale	13
Kritere vlerësimi.....	13
H2-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	14
Rezultatet e të nxënësit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënësit në shprehi profesionale	14
Kritere vlerësimi.....	14
H2-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	15
Rezultatet e të nxënësit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënësit në shprehi profesionale	15
Kritere vlerësimi.....	15
H2-08-III-0047-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit.....	15
Rezultatet e të nxënësit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënësit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	16
Njësitë e të nxënësit dhe peshat përkatëse:	16
Modalitetet e vlerësimit	17
Informacion shtesë	17
SHËNIM	17

Emërtimi i kualifikimit	“Ferma bujqësore dhe blegtoriale”			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	K-H2-III-24
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Ferma bujqësore dhe blegtoriale” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me bujqësinë dhe mbarështimin e blegtorisë;			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Ferma bujqësore dhe blegtoriale” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <p>kanë mbaruar kualifikimin profesional “Bujqësi”, nivelin II në KSHK, referuar nivelit II të KEK;</p> <ul style="list-style-type: none"> – janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucionet përgjegjëse krijojnë kushte dhe përshtatin programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin. 			
Mundësitet e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Ferma bujqësore dhe blegtoriale”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të nivelit të punonjësit të kualifikuar në tregun punës.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t'i drejtohet tregut të punës në fermat bujqësore në sektorin publik ose privat në: prodhimin bujqësor të bimëve të arave; mbrojtjen e bimëve; në pika të grumbullimit të prodhimeve bujqësore; në fermat që mbarështojnë: gjedh për prodhim qumështi dhe mishi, të imta (të leshta dhe të dhirta), derra, shpendë, në njësi apo veprimtari të tjera që aktiviteti i tyre lidhet me mbarështimin e kafshëve të fermës apo të vetëpunësohet në drejtimet e sipër përmendura në fermën e vogël familjare.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesëm dhe universitare.</p>			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H-II-02-14;H2-III-19			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Ferma bujqësore dhe blegtoriale” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehëtë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme

Rezultatet e të nxënët të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënët.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrate të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
3. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale;
4. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
5. Të organizojë drejt procesin e të nxënët të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
6. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara;
7. Të demonstrojë aftësi për të përbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
8. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
9. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
10. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollorë dhe komunitet;
11. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
12. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
13. Të vlerësojë dhe vetylerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënët (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehi profesionale).

H2-08-III-0159-24 Planifikimi dhe organizimi punës në fermat bujqësore dhe blegtoriale

Rezultatet e të nxënët në njohuri

1. Të përshkruajë zhvillimet në fushën e bujqësisë lidhur me aktivitetin e fermave bujqësore dhe blegtoriale;
2. Të përshkruajë kuadrin rregulator në fushën e bujqësisë lidhur me fermat bujqësore dhe blegtoriale;
3. Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e fermave bujqësore dhe blegtoriale;
4. Të përshkruajë sektorët/nën sektorët e fermave bujqësore dhe blegtoriale sipas karakteristikave të tyre;
5. Të përshkruajë mënyrat e planifikimit të punës ditore, javore dhe mujore;
6. Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës dhe ndarjes së detyrate në një fermë bujqësore e blegtoriale;

7. Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
8. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
9. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, sipas funksionit;
10. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
11. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës;
12. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit dhe përzgjedhjen e burimeve njerëzore sipas kualifikimeve përkatëse;
13. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të kohës dhe radhës së punës;
14. Të përshkruajë mënyrat e bashkëpunimit me eprorët dhe specialistë të tjerë të fermave bujqësore dhe blegtorale;
15. Të përshkruajë mënyrat e raportimit tek eprori;

Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale

1. Të planifikojë veprimtarinë në fermat bujqësore dhe blegtorale;
2. Të organizojë punën për realizimin e veprimtarive në fermat bujqësore dhe blegtorale;
3. Të menaxhojë burimet e nevojshme për realizimin e punës në fermat bujqësore dhe blegtorale;
4. Të dokumentojë dhe raportojë realizimin e detyrave sipas procedurave;

Kritere vlerësimi

- Planifikon veprimtaritë ditore, javore dhe mujore sipas objektivave të prodhimit;
- Planifikon proceset e punës në fermat bujqësore dhe blegtorale sipas llojit të aktivitetit;
- Planifikon kohën dhe radhën e punës sipas llojit të veprimtarisë;
- Planifikon materialet, mjetet dhe pajisjet e punës sipas proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale;
- Organizon punën në një fermë bujqësore e blegtorale sipas aktivitetit të planifikuar;
- Përcakton detyrat dhe prioritetet e një plani prodhimi ditor, favor dhe mëjor në përputhje me objektivat;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Përzgjedh dhe përdor mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas funksionit;
- Kontrollon gatishmërinë për punë të mjeteve dhe pajisjeve, sipas manualeve;
- Pastron dhe mirëmban mjetet, pajisjet dhe vendin e punës sipas instruksioneve përkatëse;
- Zbaton rregullat e higjienës së vendit të punës, sipas standardeve;
- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Përzgjedh burimet e nevojshme njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimit përkatës të tyre;
- Koordinon bashkëpunimin me eprorët dhe specialistë të tjerë të fermave bujqësore dhe blegtorale, sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formave përkatëse;
- Raporton në mënyrë periodike për realizimin e detyrave, sipas formave përkatëse;

H2-08-III-0160-24 Teknologjité e prodhimit bimor

Rezultatet e të nxënët në njohuri

1. Të përshkruajë kushtet mjedisore të ekosistemit lokal për prodhimin bimor;

2. Të përshkruajë parametrat agroklimatikë dhe orientimin gjeografik në zonën e kultivimit;
3. Të listojë platformat, mjetet dhe pajisjet digitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave agroklimatikë;
4. Të shpjegojë karakteristikat e tokave në përputhje më kërkesat e kulturave bujqësore;
5. Të tregojë metodat e vlerësimit të kushteve agroklimatike dhe cilësive fiziko-kimike të tokës;
6. Të argumentojë përcaktimin e metodave dhe parametrave për përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore;
7. Të argumentojë përzgjedhjen e mënyrës së punimit bazë dhe plotësuese të tokës sipas kulturave bujqësore;
8. Të shpjegojë llojet e punimeve përgatitore për mbjelljen e kulturave bujqësore;
9. Të shpjegojë mënyrat e ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit kullues dhe ujitës;
10. Të shpjegojë skemat e qarkullimit bujqësor në fermë dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
11. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e përdorimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve në zbatimin e teknologjive të prodhimit bimore;
12. Të shpjegojë llojet e plehrave, mënyrat dhe teknikat e plehërimit bazë dhe plotësues të tokës;
13. Të argumentojë mënyrat dhe teknikat e kontrollit të cilësisë së materialit mbjellës bimore;
14. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbjelljes së farave dhe fidanëve;
15. Të shpjegojë llojet e fidanishteve dhe teknologjitë e prodhimit të fidanëve;
16. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e mbjelljes së farave të bimëve të ndryshme në fushë dhe mjetës së mbrojtura;
17. Të shpjegojë afatet, normat e farës, distancat e mbjelljes sipas llojit të kulturave bujqësore;
18. Të shpjegojë mënyrat, teknikat e automatizuarës dhe kontrollin digjital të ujitës dhe të ushqyerit të bimëve;
19. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e krasitjeve të kulturave bujqësore;
20. Të shpjegojë llojet e sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore;
21. Të shpjegojë llojet e produkteve të lejuara të mbrojtjes së bimëve në bujqësi;
22. Të shpjegojë protokollet e trajtimeve të mbrojtjes së bimëve sipas kalendarëve vjetorë;
23. Të përshkruajë metodat e kontrollit digital të dëmtuesve në bujqësi;
24. Të shpjegojë metodat dhe teknikat e përcaktimit të kohës së pjekjes për vjelje;
25. Të listojë platformat digitale për monitorimin e kohës së vjeljes së prodhimeve bujqësore;
26. Të shpjegojë metodat dhe teknikat e vjeljeve/korrjes/kositjes të prodhimeve bujqësore;
27. Të shpjegojë mënyrat e grumbullimit dhe transportit të sigurt të prodhimeve bujqësore;
28. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e seleksionimit të prodhimit bujqësor;
29. Të argumentojë përcaktimin e kushteve të magazinimit të prodhimeve bujqësore;
30. Të listojë llojet dhe mënyrat e ambalazimit të prodhimeve bujqësore;
31. Të shpjegojë kushtet dhe masat mbrojtëse për ruajtjen e prodhimeve bujqësore;

Rezultatet e të nxenit në shprehi profesionale

1. Të përdorë platformat, mjetet dhe pajisjet digitale për matjen, regjistrimin dhe monitorimin e parametrave agroklimatikë;
2. Të vlerësojë kushtet mjetësore për kultivimin e kulturave bujqësore;
3. Të kryejë punimet bazë, përgatitore dhe plotësuese të tokës për kultivimin e kulturave bujqësore duke përdorur mjetet, pajisjet dhe makineritë përkatëse;
4. Të zbatojë teknologjitet e kultivimit të kulturave bujqësore;
5. Të kryejë shërbimet agroteknike në kulturat bujqësore;
6. Të realizojë vjeljeve/korrjes/kositjes, magazinimin dhe ruajtjen e kulturave bujqësore;

Kritere vlerësimi

- Për zgjedh dhe përdor platformat, mjetet dhe pajisjet digitale për matjen e parametrave agroklimatikë, sipas manualeve përkatëse;
- Për zgjedh dhe përdor platformat, mjetet dhe pajisjet digitale për regjistrimin e parametrave agroklimatikë, sipas katalogut përkatës;
- Për zgjedh dhe përdor platformat, mjetet dhe pajisjet digitale për monitorimin e parametrave agroklimatikë sipas katalogut përkatës;
- Grumbullon të dhëna për parametrat klimatiko-tokësore për kultivimin e kulturave bujqësore;
- Identifikon kushtet klimatike për kultivimin e kulturave bujqësore sipas llojit;
- Identifikon kushtet tokësore për kultivimin e kulturave bujqësore sipas llojit;
- Për zgjedh kulturat bujqësore për kultivim sipas planit;
- Kontrollon cilësinë e materialit mbjellës bimor (farave dhe fidanëve) sipas standardeve të përcaktuara;
- Kryen plehërimin bazë dhe plotësuese të tokës për kultivimin e kulturave duke përdorur plehrat, mjetet, pajisjet dhe makineritë përkatëse sipas kërkesave të kulturave;
- Kryen punimet bazë të tokës për kultivimin e kulturave bujqësore, duke përdorur mjetet pajisjet dhe makineritë përkatëse sipas llojit të kulturës;
- Kryen punimet përgatitore dhe plotësuese të tokës për kultivimin e kulturave, duke përdorur mjetet pajisjet dhe makineritë përkatëse sipas kërkesave të kulturave;
- Kryen mbjelljen e kulturave bujqësore sipas teknologjive përkatëse;
- Kontrollon ruajtjen e parametrave teknologjikë të mbjelljes së kulturës bujqësore;
- Kryen ujiten plotësuese të kulturave bujqësore sipas llojit dhe kushteve dhe njedisore;
- Kryen krasitjen e kulturave bujqësore sipas ciklit bimor;
- Identifikon sëmundjet dhe dëmtuesit e kulturave bujqësore sipas llojit;
- Për zgjedh produkte të lejuara të mbrojtjes së bimëve në bujqësi sipas sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore;
- Zbaton protokollet e trajtimeve të mbrojtjes së bimëve sipas kalendarëve vjetorë;
- Kryen kontroll digjital të dëmtuesve në bujqësi, sipas katalogut përkatës;
- Përdor metodat dhe teknikat e duhura të përcaktimit të kohës së pjekjes për vjelje, sipas destinacionit të përdorimit;
- Përdor platformat digjitale për monitorimin e kohës së vjeljes së prodhimeve bujqësore sipas manualeve përkatëse;
- Zbaton metodat dhe teknikat e vjeljeve/korrjes/kositjes të prodhimeve bujqësore sipas llojit të kulturës;
- Kryen grumbullimin dhe transportin e sigurt të prodhimeve bujqësore sipas standardit;
- Seleksionon prodhimet bujqësore sipas mënyrave dhe teknikave përkatëse;
- Magazinon prodhimet bujqësore sipas standardeve;
- Ambalazhon prodhimet bujqësore sipas kërkesave të tregut;
- Ruan prodhimet bujqësore sipas kushteve përkatëse;

H2-08-III-0161-24 Teknologjitet e prodhimit blegtoral

Rezultatet e të nxënët në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e kafshëve dhe shpendëve që mbarështohen në fermë;
2. Të shpjegojë treguesit normal jetësorë të kafshëve dhe shpendëve në fermë;

3. Të shpjegojë kushtet e strehimit dhe mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshëve, shpendëve dhe kategorive të tjera;
4. Të shpjegojë llojet e ushqimeve, përdorimi i tyre sipas karakteristikat dhe kategorive të kafshëve dhe shpendëve;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të racioneve ushqimore sipas kategorive të kafshëve, shpendëve dhe destinacionit të prodhimit;
6. Të shpjegojë teknologjitet e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve në fermat blegtore sipas ciklit jetësor dhe destinacionit të prodhimit;
7. Të shpjegojë mënyrat e parandalimit të kontaminimit të ushqimeve të kafshëve;
8. Të shpjegojë shenjat klinike të sjelljes jo normale të kafshëve dhe shpendëve;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së të ushqyerit sipas llojit, kategorive të kafshëve, shpendëve dhe gjendjes fiozologjike;
10. Të listojë pajisjet e automatizuara dhe të kontrollit digjital për ushqyerjen, matjen e parametrave shëndetësore, riprodhues dhe mjeljen e kafshëve duke përshkruar përdorimet e tyre;
11. Të listojë pajisjet digitale për monitorimin e parametrave mikroklimatikë në stallë dhe për të përcaktuar vendndodhjen e kafshëve në kullotë;
12. Të shpjegojë rëndësinë e higjenës të ujit, mjeteve dhe impianteve të tij;
13. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve të higjenës gjatë procesit të mjeljes;
14. Të përshkruajë llojet e detergjenteve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar dhe përdorimet e tyre;
15. Të përshkruajë procedurat e pastrimit të impianteve mjelës, enëve apo pajisjeve të qumështit;
16. Të shpjegojë teknologjitet e grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve blegtore;
17. Të shpjegojë mënyrat e përpunimit të plehut dhe kompostimit të mbetjeve organike;
18. Të shpjegojë mënyrat e riciklimit të mbetjeve shtazore dhe bimore;
19. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e përdorimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve në zbatimin e teknologjive të prodhimit blegtoral;
20. Të interpretojë aktet ligjore dhe nënligjore që veprojnë në fushën e mirëqenies së kafshëve dhe shpendëve;
21. Të shpjegojë treguesit normal jetësorë të kafshëve dhe shpendëve në fermë;
22. Të shpjegojë shenjat klinike të sjelljes jo normale të kafshëve dhe shpendëve;
23. Të shpjegojë burimet e infeksionit te kafshët dhe shpendët;
24. Të argumentojë masat për profilaksinë e përgjithshme;
25. Të përshkruajë rëndësinë e masave veterinare, për mbrojtjen e shëndetit publik;
26. Të dallojë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes;

Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale

1. Të zbatojë kushtet e strehimit në stallë sipas kategorive të kafshës dhe shpendëve;
2. Të përdorë pajisjet digitale për monitorimin e parametrave jetësor dhe riprodhues, mikroklimatikë në stallë, si dhe vendndodhjen e kafshëve në kullotë;;
3. Të zbatojë teknologjitet e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve sipas llojit dhe kategorive;
4. Të zbatojë mënyrat e parandalimit të kontaminimit të ushqimeve të kafshëve dhe shpendëve;
5. Të zbatojë standardet e higjenës së ujit, ushqimeve, mjeteve, pajisjeve dhe impianteve, duke përdorur llojet e detergjenteve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar;
6. Të identifikojë treguesit jetësorë të kafshëve dhe shpendëve në fermë, si dhe sjelljet jonormale të kafshëve dhe shpendëve;
7. Të zbatojë masat profilaktike të përgjithshme për ruajtjen e shëndetit të kafshëve dhe

- shpendëve;
8. Të zbatojë rregullat gjatë procesit të pjelljes në kategori të ndryshme të kafshëve bujqësore;

Kritere vlerësimi

- Zbaton kushtet e strehimit në stallë sipas kategorive të kafshëve dhe shpendëve;
- Përdor pajisjet digitale për monitorimin e parametrave mikroklimatikë në stallë sipas manualeve përkatëse;
- Përdor pajisjet digitale për të përcaktuar vendndodhjen e kafshëve në kullotë sipas manualeve përkatëse;
- Të zbatojë teknologjitet e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve sipas llojit dhe kategorive;
- Përzgjedh llojet e ushqimeve sipas llojit dhe kategorive të kafshëve dhe shpendëve;
- Zbaton teknologjitet e të ushqyerit të kafshëve dhe shpendëve në fermat blegtorale sipas ciklit jetësor dhe destinacionit të prodhimit;
- Zbaton normat e racioneve ushqimore sipas llojit, kategorive të kafshëve e shpendëve dhe destinacionit të prodhimit;
- Përshtat mënyrën e të ushqyerit në raste të sjelljeve jonormale sipas llojit dhe kategorive të kafshës dhe shpendëve, si dhe rekomandimeve të specialistëve;
- Përdor pajisjet e automatizuara dhe digitale për ushqyerjen kafshëve dhe shpendëve sipas manualeve përkatëse;
- Përdor pajisjet e automatizuara për matjen e parametrave shëndetësore dhe riprodhues sipas manualeve përkatëse;
- Përdor pajisjet e automatizuara dhe digitale për mjeljen e kafshëve, sipas manualeve përkatëse;
- Parandalon kontaminimin e ushqimeve të kafshëve dhe shpendëve, sipas rregullave dhe llojit të ushqimit;
- Zbaton rregullat e higjienës të ujit, mjeteve dhe impianteve të tij, sipas standardeve;
- Kontrollon procesin e mjeljes sipas standardeve të higjienës;
- Kontrollon përdorimin e detergjenteve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar sipas udhëzuesve të përdorimit;
- Zbaton procedurat e pastrimit të impianteve mjelës, enëve apo pajisjeve të qumështit sipas manualeve dhe standardeve të higjienës;
- Kontrollon treguesit jetësorë të kafshëve dhe shpendëve në fermë sipas normave përkatëse të caktuara;
- Identifikon shenjat e sjelljes jonormale në kafshë dhe shpendë, sipas llojit;
- Raporton te mjeku veteriner treguesit jetësorë në rast të sjelljes jonormale të identikuara;
- Zbaton masat profilaktike të përgjithshme për ruajtjen e shëndetit të kafshëve dhe shpendëve sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton masave e përgjithshme për mbrojtjen e shëndetit publik, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dallon shenjat e pjelljes në kafshë të ndryshme sipas sjelljes së tyre;
- Kujdeset dhe jep ndihmën e parë për kafshët gjatë pjelljes sipas rastit;

H2-08-III-0162-24 Teknologjitet e prodhimit biologjik

Rezultatet e të nxënët në njohuri

1. Të përshkruajë ligjin Shqiptar për bujqësinë biologjike;
2. Të përshkruajë direktivën evropiane për bujqësinë organike;
3. Të përshkruajë normat teknike për prodhimin biologjik bimor;

4. Të përshkruajë llojet e plehrave, metodat, teknikat dhe mjetet e plehërimit organik;
5. Të listojë plehrat organike dhe minerale/shtuesit e lejuar në bujqësinë biologjike;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e përpunimit të plehut organik;
7. Të shpjegojë mënyrat e punimeve të tokës, teknikat dhe mjetet e punimeve minimale;
8. Të përshkruajë metodat e ruajtjes së pjellorisë natyrore të tokës në bujqësinë biologjike;
9. Të listojë metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive biologjike të tokës;
10. Të listojë metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive fiziko-kimike e biologjike të ujit;
11. Të listojë metodat dhe treguesit për vlerësimin e biodiversitetit në fermën biologjike;
12. Të shpjegojë metodat dhe teknikat e prodhimit të fidanëve në bujqësinë biologjike;
13. Të përshkruajë normat teknike të shërbimeve agroteknike në bujqësinë biologjike;
14. Të listojë preparatet e lejuara për mbrojtjen e bimëve në bujqësinë biologjike;
15. Të përshkruajë metodat dhe teknikat që përdoren për kontrollin biologjik të dëmtuesve;
16. Të përshkruajë platformat digitale për kontrollin e dëmtuesve në bujqësinë biologjike;
17. Të përshkruajë pajisjet digitale për monitorimin e kohës së vjeljes të produkteve biologjike;
18. Të shpjegojë teknikat dhe mjetet për korren, kositjen dhe vjeljen në bujqësinë biologjike;
19. Të shpjegojë teknikat dhe metodat e manipulimit të produkteve biologjike të pas vjeljes;
20. Të përshkruajë llojet e ambalazheve ekologjike dhe teknikat e ambalazhimit;
21. Të përshkruajë normat teknike për prodhimin biologjik blegtoral;
22. Të përshkruajë parametrat teknologjikë për prodhimin e ushqimit blegtoral biologjik;
23. Të përshkruajë normat teknike të mbarështimit, kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies së kafshëve dhe shpendëve për prodhime biologjike;
24. Të përshkruajë normat teknike të kontrollit, certifikimit dhe etiketimit të produkteve në bujqësinë biologjike;
25. Të shpjegojë çfarë përfaqësojnë logot e prodhimit biologjik dhe rëndësinë e tyre;
26. Të përshkruajë teknologjinë e grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve bimore dhe blegtoreale biologjike;

Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale

1. Të zbatojë ligjin shqiptar, direktivën evropiane dhe normat teknike në prodhimin biologjik në fermat bujqësore e blegtoreale;
2. Të zbatojë teknologjinë e prodhimit biologjik në fermat bujqësore;
3. Të kryejë shërbimet agroteknike në fermat bujqësore biologjike;
4. Të zbatojë teknologjinë e prodhimit biologjik në fermat blegtoreale;
5. Të zbatojë normat teknike të mbarështimit, kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies së kafshëve dhe shpendëve për prodhime biologjike;
6. Të kryejë ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin, kontrollin dhe certifikimin e prodhimit biologjik në fermat bujqësore e blegtoreale;
7. Të zbatojë teknologjinë e vjeljes, grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve bimore dhe blegtoreale biologjike;

Kritere vlerësimi

- Zbaton ligjin shqiptar për bujqësinë biologjike;
- Zbaton direktivën evropiane për bujqësinë organike;
- Zbaton normat teknike për prodhimin biologjik bimore sipas legjisacionit;
- Përdor llojet e plehrave, metodat, teknikat dhe mjetet e plehërimit organik sipas irregulloreve përkatëse;
- Përdor plehrat organike dhe minerale/shtuesit e lejuar në bujqësinë biologjike sipas irregulloreve

përkatëse;

- Zbaton mënyrat dhe teknikat e përpunimit të plehut organik sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton mënyrat e punimeve të tokës, teknikat dhe mjetet e punimeve minimale sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat e ruajtjes së pjellorisë natyrore të tokës në bujqësinë biologjike sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive biologjike të tokës sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive fiziko-kimike e biologjike të ujit sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton metodat dhe teknikat e prodhimit të fidanëve në bujqësinë biologjike sipas rregulloreve përkatëse dhe llojit të kulturës;
- Zbaton normat teknike të shërbimeve agroteknike në bujqësinë biologjike sipas rregulloreve përkatëse dhe llojit të kulturës;
- Përdor preparatet e lejuara për mbrojtjen e bimëve në bujqësinë biologjike sipas legjislacionit;
- Zbaton metodat dhe teknikat që përdoren për kontrollin biologjik të dëmtuesve sipas rregulloreve përkatëse;
- Përdor platformat digitale për kontrollin e dëmtuesve në bujqësinë biologjike sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor pajisjet digitale për monitorimin e kohës së vjeljes të produkteve biologjike sipas manualeve të përdorimit;
- Zbaton teknikat dhe mjetet për korrjen, kositjen dhe vjeljen në bujqësinë biologjike sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton normat teknike për prodhimin biologjik blegtoral sipas legjislacionit;
- Zbaton parametrat teknologjikë për prodhimin e ushqimit blegtoral biologjik sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton normat teknike të mbarështimit, kujdesit shëndetësor dhe mirëgenies së kafshëve dhe shpendëve për prodhime biologjike sipas rregulloreve përkatëse;
- Kryen kontrollin, certifikimin dhe etiketimin e produkteve bujqësore e blegtorelle biologjike;
- Përdor logot e miratuara të prodhimit biologjik sipas legjislacionit;
- Zbaton teknologjinë e grumbullimit dhe ruajtjes së prodhimeve bimore dhe blegtorelle biologjike sipas rregulloreve përkatëse;

H2-08-III-0163-24 Përpunime të thjeshta të prodhimit në fermat bujqësore dhe blegtorelle

Rezultatet e të nxënët në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë ekonomike të përpunimeve të thjeshta të prodhimeve bimore dhe blegtorelle;
2. Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet e pastrimit të prodhimeve bimore dhe blegtorelle;
3. Të përshkruajë mënyrat dhe materialet për pastrimin dhe higjenizimin e prodhimeve bimore dhe blegtorelle;
4. Të shpjegojë mënyrat e parapërgatitjes së lëndëve të para bimore dhe blegtorelle për përpunime të thjeshta;
5. Të listojë llojet e prodhimeve bimore dhe blegtorelle për përpunime të thjeshta;
6. Të përshkruajë llojet e pajisjeve dhe mjeteve të punës për përpunime të thjeshta të prodhimeve bimore dhe blegtorelle;

7. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e përpunimit artizanal të prodhimeve bimore (drithërave, frutave, perimeve, bimëve vajore etj.);
8. Të listojë llojet e konservantëve për përpunime të thjeshta të frutave dhe perimeve dhe përdorimet e tyre;
9. Të shpjegojë mënyrat, teknikat dhe mjetet e përpunimit artizanal të qumështit;
10. Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë;
11. Të përshkruajë llojet e ambalazheve ekologjike dhe teknikat e ambalazhimit të produkteve bimore dhe blegtorale të përpunuara;
12. Të shpjegojë kushtet teknike për ruajtjen e produkteve të përpunuara bimore dhe blegtorale;
13. Të përshkruajë kushtet e higjenës dhe sigurisë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së produkteve bimore dhe blegtorale;

Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale

1. Të zbatojë mënyrat dhe teknikat për përpunime të thjeshta të prodhimeve bujqësore;
2. Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e pastrimit, parapërgatitjes dhe klasifikimit të prodhimeve bimore dhe blegtorale për përpunime të thjeshta;
3. Të përdorë llojet e pajisjeve dhe mjeteve të punës për përpunimin e thjeshtë të prodhimeve bimore dhe blegtorale;
4. Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e përpunimit të thjeshtë artizanal të prodhimeve bimore;
5. Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e përpunimit të thjeshtë artizanal të prodhimeve blegtorale;
6. Të përdorë ambalazhe ekologjike për produktet bimore dhe blegtorale të përpunuara;
7. Të zbatojë kushtet e higjenës dhe sigurisë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së produkteve bimore dhe blegtorale;

Kritere vlerësimi

- Kryen përpunime të thjeshta të prodhimeve bimore dhe blegtorale sipas teknikave përkatëse;
- Zbaton mënyrat dhe teknikat e pastrimit dhe higjenizimit të prodhimeve bimore dhe blegtorale sipas llojit të produktit;
- Përdor mjetet dhe materialet për pastrimin dhe higjenizimin e prodhimeve bimore dhe blegtorale sipas llojit të produktit;
- Zbaton mënyrat e parapërgatitjes së lëndëve të para bimore dhe blegtorale për përpunime të thjeshta sipas llojit të produktit;
- Klasifikon prodhimet bimore dhe blegtorale për përpunime të thjeshta sipas llojit të produktit;
- Përdor llojet e pajisjeve dhe mjeteve të punës për përpunimin e thjeshtë të prodhimeve bimore dhe blegtorale sipas manualeve të përdorimit;
- Zbaton mënyrat dhe teknikat e përpunimit artizanal të prodhimeve bimore (drithërave, frutave, perimeve, bimëve vajore etj.) sipas llojit të produktit;
- Zbaton mënyrat, teknikat dhe mjetet e përpunimit artizanal të qumështit sipas rregullave përkatëse;
- Zbaton mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë sipas rregullave përkatëse;
- Përdor ambalazhe ekologjike dhe teknikat e ambalazhimit të produkteve bimore dhe blegtorale të përpunuara sipas rregullave përkatëse;
- Zbaton kushtet teknike për ruajtjen e produkteve të përpunuara bimore dhe blegtorale sipas rregullave përkatëse;
- Zbaton kushtet e higjenës dhe sigurisë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së produkteve bimore dhe

blegtorale sipas manualeve përkatëse;

H2-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënët në njohuri

1. Të përshkruajë parimet bazë të kodit të punës dhe legjislacionin përkatës lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Të shpjegojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
3. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjeve të materialeve të punës;
4. Të përshkruajë mënyrat e hartimit të grafikut të punës;
5. Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat;
6. Të argumentojë rëndësinë e informimit nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
7. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostove të prodhimit në fermat bujqësore dhe blegtorale;
8. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për produktet që do të ofrojë;
9. Të shpjegojë mënyrat e sigurimit të mjeteve, materialeve, dhe pajisjeve të nevojshme;
10. Të shpjegojë teknikat e marketingut për produktet bimore dhe blegtorale;
11. Të përshkruajë llojet e institucioneve financiare dhe shërbimet e tyre;
12. Të përshkruajë nocionin e të ardhurave dhe shpenzimeve në fermat bujqësore dhe blegtorale;
13. Të përshkruajë teknika të vetëvlerësimit;
14. Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
15. Të argumentojë rëndësinë e teknologjisë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin e prodhuesit në fermat bujqësore dhe blegtorale;
16. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
17. Të argumentojë rëndësinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita;
18. Të përshkruajë llojet e trajnimeve dhe kurseve teknike.

Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionalë

1. Të zbatojë detyra administrative dhe tregtarë;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të zhvillohet profesionalisht;
4. Të informohet për teknologjinë bashkëkohore dhe të informojë bashkëpunëtorët;

Kritere vlerësimi

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e fushës;
- Plotëson planin e punës në përputhje me detyrën e dhënë;
- Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike sipas rregullave;
- Zbaton grafikun e punës, sipas proceseve;
- Kryen sigurimin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme sipas nevojës;
- Zbaton teknikat e marketingut për prodhimet bujqësore dhe blegtorale;
- Plotëson dokumentacionin për bashkëpunimet me institucionet financiare dhe shërbimet e tyre;
- Përgatit oferta për produktet referuar çmimeve aktuale të tregut;
- Regjistron të dhënat e faturave të shitjes dhe marrjes së porosive sipas kërkesës;
- Llogarit koston dhe çmimin përfundimtar për prodhimet sipas rregullave;
- Merr informacion nga tregu për çmimet dhe cilësinë e imputeve bujqësore sipas ofertës në treg;

- Kryen vazhdimisht trajnime për zhvillimin profesional dhe të karrierës sipas planit të kualifikimit;
- Merr pjesë vazhdimisht në panaire dhe ekspozita në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë sipas kalendarit të aktiviteteve;
- Përdor teknologjinë bashkëkohore për proceset e punës në bujqësi dhe blegtori, sipas rregullave;
- Informon në kohë bashkëpunëtorët për zbatimin e teknikave të reja në fermat bujqësore dhe blegtorale sipas rregullave;

H2-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënësit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrat e dhënies/marrjes së informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të shpjegojë metodat e komunikimit;
3. Të argumentojë zbatimin e parimeve të punës në grup;
4. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
5. Të shpjegojë kodin e etikës profesionale;
6. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
7. Të përshkruajë mënyrat e bashkëpunimit më eprorët dhe kolegët;
8. Të shpjegojë përdorimin e teknologjisë së informacionit në komunikimin me të tjerët;
9. Të argumentojë përdorimin e terminologjisë profesionale;
10. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

Rezultatet e të nxënësit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në komunikim;
3. Të zbatojë kodin e etikës;
4. Të përdorë terminologjinë profesionale të bujqësisë;

Kritere vlerësimi

- Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Zbaton parimet e punës në grup sipas rregullave përkatëse;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët sipas kodit të etikës;
- Zbaton teknikat e komunikimit për të arritur një komunikim efektiv sipas rregullave përkatëse;
- Zbaton kodin e etikës në mënyrë korrekte;
- Zgjidh probleme dhe mosmarrëveshje duke përdorur teknikat dhe rregullat përkatëse;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët sipas rregullores së brendshme;
- Përdor saktë terminologjinë profesionale të fushës;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

H2-08-III-0047-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënësit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjisacionit në fuqi dhe standardeve për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;

2. Të shpjegojë domosdoshmérinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të listojë mënyrat dhe llojet e mjeteve të ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të interpretojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
5. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
6. Të përshkruajë përdorimin e pajisjeve, rregullave të shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
7. Të shpjegojë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përbajtje kimike;
8. Të argumentojë domosdoshmérinë e përdorimit të kufizuar të pesticideve në ruajtjen e tokës nga ndotjet kimike;
9. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
10. Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
11. Të përshkruajë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
12. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
13. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e riciklimit të mbetjeve organike bimore dhe shtazore;
14. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste e gjendjeve të jashtëzakonshme;

Rezultatet e të nxënët në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjispcionin dhe standartet e sigurimit teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë;
2. Të zbatojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
3. Të zbatojë sinjalistikën në mjedisin e punës dhe procedurat e evakuimit për raste emergjence;
4. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit;
5. Të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen e mjedisit nga mbetjet e ndryshme;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjispcionit në fuqi dhe standartet për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Përdor manualet e mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas rastit;
- Zbaton rregullat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti sipas rastit;
- Zbaton sinjalistikën në mjedisin e punës sipas sektorëve të prodhimit bimor dhe blektoral;
- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjence sipas rastit;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përbajtje kimike;
- Përdor në mënyrë të kufizuar pesticideve dhe dezifikantët për ruajtjen e mjedisit nga ndotjet kimike sipas rregulloreve përkatëse;
- Respekton karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Depoziton mbetjet nga procesi i punës sipas rregulloreve përkatëse;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Zbaton mënyrat dhe teknikat e riciklimit të mbetjeve organike bimore dhe shtazore sipas llojit dhe rregulloreve përkatëse;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Njësité e të nxënët dhe peshat përkatëse:

Nr.	Njësi të nxënëi	Peshat në %	Kodet
------------	------------------------	--------------------	--------------

1	Planifikimi dhe organizimi i punës në fermat bujqësore dhe blegtoriale	10	H2-08-III-0159-24	
2	Teknologjitet e prodhimit bimor	25	H2-08-III-0160-24	
3	Teknologjitet e prodhimit blegtoral	25	H2-08-III-0161-24	
4	Teknologjitet e prodhimit biologjik	12	H2-08-III-0162-24	
5	Përpunime të thjeshta të prodhimit në fermat bujqësore dhe blegtoriale	6	H2-08-III-0163-24	
6	Sipërmarrje dhe edukim karriere	8	H2-32-III-0013-24	
7	Komunikimi dhe etika profesionale	6	H2-31-III-0014-24	
8	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	8	H2-08-III-0047-24	
Totali		100		

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëlojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individ i nënshtronhet vlerësimit të vazduar, përbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individ i vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidencia për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritura e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuara.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të nxënësit

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikimi i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- njohjes të nxënësit të mëparshëm informal dhe joformal;
- njohjes të nxënësit të përfstuar jashtë vendit;
- formave të tjera të përcaktuara me ligj

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-H2-III-24**

K - Kualifikim

- H** - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit
2 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës
III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK
24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënët: **H2-08-III-0159-24**

- H2** - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit
08 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënët
III - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënët në strukturën e KSHK
0159 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënët në ditën e hartimit përkatës
24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënët